



Npi – 01/480 datë: 27.12.2023

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 27.12.2023, është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLLEDHJES SË -IX- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES
E thirrur për datën: 27.12.2023, (e mërkurë) në ora 09.⁰⁰ h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Kuvendit: z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Veliu, z.Kadri Emiri, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj, z.Artan Lubovci, z.Përparim Ramusa, znj.Adelina Beqaj, znj.Albana Podvorica, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Rrahman Jakupi, z.Lumni Amrushi, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, z.Reshat Mujota, dhe z.Rexhep Gashi.

Në mbledhje përveç anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemajl Aliu, Drejtorët, Shefja e Kabinetit, znj.Anita Kurti, Përgjegjëse e ZKF-së znj.Kimete Ukaj, RZSH, Muhamet Hoxha, Asistente e Kryesuesit, znj.Gentiana Mehmeti, Zyrtarët e IT-së, Zyrtare e Informimit, znj.Vlora Hyseni dhe praktikantet, znj.Valmira Hoxha, znj.Sadbere Halili dhe znj.Donjeta Qorrolli.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit konstatoj, Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 27.11.2023,
2. Draft-Rregullore për përcaktimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim më pak se një vitë të pronës Komunale (Pas diskutimit publik),
3. Draft-Rregullore për Procedurat dhe Kriteret për zgjedhjen e Lauratëve të vitit në sport, (Pas diskutimit publik),
4. Draft-Strategjia e zhvillimit ekonomik të Komunës së Shtimes, (Pas diskutimit publik),
5. Shqyrtimi i Draft-Planit të Punës së Kuvendit dhe Orarit të mbledhjeve për vitin 2024,
6. Draft- Programi Strategjik për ujërat në Komunën e Shtimes, (Për diskutim Publik)
7. Draft-Rregullore për caktimin e orarit të punës për bizneset në Komunën e Shtimes, (Për diskutim Publik)
8. Pyetje – Përgjigje.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Para se ta qes në votim rendin e ditës, unë si Kryesues e propozoj edhe një pikë shtesë që është përgaditur në ndërkohë e që është “Draft-rregullore për sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Shtimes”.

znj.Adelina Beqaj; Përshëndetje, për sa i përket rendit të ditës, e kemi një propozim nga Kryesuesi për një pikë shtesë “Draft-rregullore për sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Shtimes”, por si mundë ta lexojmë ne këtë Draft-rregullore për këtë kohë kaq të shkurtër, kështu që unë nuk jam që të futet kjo pikë shtesë e rendit të ditës.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, qysh mundet me ardhë një rregullore e tillë sot, për me futë në rendin e ditës, kështu nuk mundet me funksionu Komuna. Duhet të jesh pak më serioz Kryetar, sepse ne po flasim para qytetarëve. Kjo e donë një analizë të mirë, e kjo me futë sot është një hajgare. Unë kisha kërkuar me shty sepse kjo nuk është në rregull.

z.Kadri Emini; Përshëndetje, dëshirojë me ndëgju Kryetarin për këtë propozim.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, pak është vonë për ta lexuar, unë po pres një sqarim për këtë propozim, për pikë shtesë.

z.Reshat Mujota; Përshëndetje, sa i përket rendit të ditës edhe unë po quditem se si gjithë ky material të propozohet si pikë shtesë. Kërkoj që pika e 8 e rendit të ditës të del në pikën e dytë të rendit të ditës sepse drejtorët duhet me pritë deri në fund të mbledhjes për këtë pikë. Për propozimin e Kryesuesit unë kërkojë për me u shty për mbledhje tjetër.

z.Hamëz Tërshani; Përshëndetje, për mbledhjen e fundvitit unë kam menduar se duhet ta bëjmë të relaksuar. Kta janë qaq të pasinqert sa na la me kuptu se pse po presim. Kjo është njëfarë revanshizmi. Pyetje-përgjigje është e gabueshme me lënë si pikë e tetë. Na jepni kohë për konsulltim sepse nuk kemi mundur me lexuar materialin.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Kjo rregullore ka ardhur nga eksertët që e kanë hartuar. Nuk kemi pasë rregullore që nga viti 2009. Kjo është buxhetuar, dhe numri i të punësuarëve është 711 dhe nuk ka shansë me u rrit ky numër.

Kryetari, z.Qemaj Aliu; Përshëndetje, më lejoni të prezantojë “Projekt rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës”. Ky draft ka qenë planifikuar të kryhet deri në shtator por është shty deri në fund të vitit. Është obligim për të gjitha Komunat. Kemi angazhuar ekspertë të kësaj fushe siç është z.Hajdin Ramadani, që ka punuar për 7 muaj në hartimin e këtij drafti. Kjo rregullore nuk ka qëllim diskriminimi ose denigrimin, por përkundrazi ka qëllim avansimin e tyre. 711 është numri aktual i të punësuarëve në Komunën e Shtimes, me Arsim, Shëndetësi etj. Qëllimi i rregullores është të jenë të barabart dhe mos të ketë dallime mes zyrtarëve, në përputhje me punën dhe përgjegjësinë të tyre. Kjo rregullore është e buxhetuar dhe kjo tani po pasqyrohet me rregullore. Koeficientet janë të pasqyruara në buxhet. Na vjen keq që nuk kemi mujtë me punu edhe me pru deri tani, por është punuar me intenzitet të lartë. Do të stimulohen ata që punojnë më shumë, nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem.

z.Rexhep Gashi; Përshëndetje, është me u befasu me opozitarizimin që e kemi bërë atëherë më herët. Ju tani po e bëni të njëjtin rastë. Ju e keni fitu pushtetin dhe Kryetari po bjen në kundërshtim me vetveten, kur thotë se e kemi pasur afatin deri në Shtator e tash po na vjen në Dhjetor. Për pikat e rendit të ditës unë ju kam përkrahur, mirëpo për pyetje-përgjigje duhet të jetë e dyta si pikë e rendit të ditës. Unë nuk jamë matrapazllak, nuk jamë për me hyp në karrik unë rri në opozitë.

z.Reshat Mujota; Prita nga Kryetari pak më shumë sqarime. Në organogram po del që i kemi 11 drejtori. Qështja tjetër është se kemi drejtori për buxhet. Kam thënë se anëtarë e Kuvendit po votojnë buxhet pa e ditur fare, pyetje a do të funksionojë kjo drejtori e Inovacionit a ka buxhet për këtë Drejtori. Asnjë të mirë nuk ja kemi pa kësaj Drejtorie. Po del se duhet me u rehatu dikush.

z.Hamëz Tërshani; Është e rëndësishme të diskutojmë për këtë pikë, unë jamë i gatëshëm ta mbajmë një mbledhje të veqantë. Eksperti që ka punu edhe në ligjin e pagave, e të cilin e ka rrëzuar gjykata kushtetuese kjo e bën edhe me të diskutueshëm. Kjo qka jeni duke bërë është e gabueshme, unë po dua me pas kohë me lexu.

znj.Adelina Beqaj; Kjo rregullore nuk shkon në diskutim publik. Rregullores ja lëshova një sy dhe nuk pashë asnjë emër të Komunës sonë. Ju mundeni me votu se i keni numrat por anëtarët profesionistë duhet që ta shohin se qka janë doke votuar.

z.Rrahman Jakupi; Të nderuar qytetarë të Shtimes dhe ju prezentë në sallë. E përmendi zonja Beqa dhe zotri Mujota për numrin e drejtorive dhe organogramin me 11 drejtori, dhe në këto drejtori ka edhe përgjegjës që duhet me u avansuar nga ju. Në vazhdim ky lexoi një nen të U.A që duhet të shkojë në diskutim publik. Ndoshta ata zyrtarët që e kanë punuar nuk e kanë parë këtë U.A. mirëpo nuk punohet ashtu qysh doni ju.

z.Përparim Ramusa; Para kuvendarëve u thanë gjëra të pavërteta. Nëse kjo ka lidhje me ligjin e pagave pse nuk e ke pru ma herët. Kjo është e pandershme, pse nuk po bëhet edhe për shëndetësi edhe për arsim. Kolegë kqyrni qka po votoni se keni me u skuqur më vonë.

z.Besnik Seferi; Kemi ra në pozitë të palakmueshme sepse është dashur që para 7 ditëve të vijë kjo rregullore çdo draft rregullore duhet ta kemi më herët për ta lexuar. Ne si vetëvendosje nuk e kemi një shef por të gjitha jemi shefa të vetëvetës.

z.Rexhep Gashi; Emri që u lakua nga parafolësi tregon vetë. E kemi një ekspert të Kuvendit, pse nuk ka ardh material me herët që nga Korriku. VV nuk jamë dhe nuk do të jem kurrë.

z.Kadri Emini; U diskutua mjaftë shumë pse me futë si pikë. U tha nga Kryetari arsyja pse u vonua. Kryetari e ka kompetencën e plotë që me vendim të veçantë me kry sistematizimin, dhe nuk është obligim ligjor me dalë në diskutim publik. Pajtohem që nuk është mirë me na ardhë material me vonesë.

z.Lumni Amrushi; Përshëndetje, në bazë të informatave që i kemi nga kolegët, që kanë punu në administratë, shumë prej tyre nuk e din se qka do të ndodhë me fatin e tyre. Ky dokument është aq kofidencial të cilin në momentin e fundit e keni pru këtu. Është dashur të bëhet debat me zyrtarë së paku. Kam respekt për këta se kemi punuar bashkë, propozojë që kjo pikë të shtyhet, të shkojë te zyrtarët në emaila e tyre zyrtare.

Kryetari, z.Qemaj Aliu; Edhe një herë, për sa i përket drejtorive në kohën kur ka kaluar buxheti ju jeni marrë me punë tjera dhe nuk e keni lexuar fare dokumentin, keni qenë tu u marrë me bllokimin e punës së Kuvendit. Statuti e thotë çdo vitë buxhetor caktohet numri i drejtorive dhe stafit. Prishtina që 9 vite e bënë me vendim të Kryetarit, unë nuk po dua me vendim por me rregullore. Para se me i shku mendja dikujt mua të parit më ka shkua mendja se unë nuk e bëjë një gjë të tillë sepse të gjithë kemi me pasë ngritje. MAPL-ja do ta kundërshtojë nëse është në kundërshtim me ligjin. Ky dokument ka me qenë aset, ka me qenë mostër edhe për Komunat e tjera si dokument përmbajtësor.

z.Përparim Ramusa; Kryetar dole në mospërputhje me fjalët e tua, mirë që e ke pru në Kuvend por jepna kohë që ta lexojmë. Të kuptojë që je tu u ni keq se ta ka pru rregulloren para mbledhjes. Ti kryetarë nuk je në pozicion me i rritë koeficientin. Ne si PDK jemi me shty pikën shtesë.

z.Kadri Emini; Ne nuk jemi me i ndëshkuar punëtorët e administratës. Po material me na ardhur me kohë edhe në KPF.

z.Reshat Mujota; Shyqyr që nuk jam në një grup parlametar por jam vetvetja. Kryetari edhe pergjigjen kur e jep e jep me tendencë. Unë e kam lexuar buxhetin se thave jeni marrë me çështje tjera. Sqarona buxhetin për drejtorinë e inovacionit. Unë mundem me kërku falje po shihet këtu kush ka punuar dhe kush ka përfituar.

z.Rexhep Gashi; Kërkojë nga sekretaria me na sqaruar pse material nuk na ka ardhur me kohë, keni pasur mjaftë kohë.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Unë dhashë sqarime se është punuar deri dje në orët e vona.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Konstatoi kuorumin prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

*Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 8 vota "Për", me 10 vota "Kundër" dhe me 3 vota "Abstenim" nuk miratohet propozimi për ta futë si pikë shtesë "Draft-Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës".

* Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 10 vota "Për", me 11 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" nuk e miratoi propozimin që pika e tetë të kalojë në pikën e dytë të rendit të ditës.

* Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 13 vota “Për”, me 2 vota “Kundër” dhe me 5 vota “Abstenim” miratoi rendin e ditës ashtu siç ka ardhur nga Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi dhe Kryetari, z.Qemajl Aliu.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 27.11.2023

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

*Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 13 vota “Për”, me 0 vota “Kundër” dhe me 3 vota “Abstenim”, miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 27.11.2023.

Pika 2

Draft-Rregullore për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim më pak se një vitë të pronës Komunale (Pas diskutimit publik)

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Komiteti për Politikë dhe Financa e ka miratuar këtë pikë fjalën ja japim z.Grejtalb Emini.

z.Grejtalb Emini, DPUKGJ; Përshëndetje, e kemi mbajtur diskutimin publik, është nevojë e qytetarëve. Unë nuk do ta zgjati, nëse ka pyetje do të përgjigjem, ju ftojë ta votoni.

z.Përparim Ramusa; Të falenderojë për bashkëpunimin për këtë rregullore është në interes të qytetarëve, dhe do ta votojmë.

z.Besnik Seferi; Edhe ne e mbështesim këtë rregullore sepse është në të mirën e qytetarëve.

z.Muhamet Ademaj; Edhe ne si LDK-AKR e mbështesim këtë rregullore.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Konstatoi kuorumin prej 13 anëtarëve prezent në mbledhje.

*Kuvendi Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Rregulloren për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim Pronën e Paluajtshme Komunale për më pak se një vit.

Pika 3

Draft-Rregullore për Procedurat dhe Kriteret për zgjedhjen e Lauratëve të vitit në sport.
(Pas diskutimit publik)

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Lexoi rekomandimin e KPF-së, dhe fjalën ja dha znj.Albana Fazliu.

znj.Albana Fazliu, DKRS; Përshëndetje, ju e keni marrë metarialin me kohë dhe e keni lexuar. Diskutimin publik e kemi mbajtur, në vazhdim lexoi propozimet nga debati publik si vijon: 1. Të inkorporohet në rregullore si vijon - Ekipi me struktura të kompletuara dhe ekipi më i organizuar me të gjitha kategorit e grupmoshave. 2. Te shpërblimet të shtohet: Edhe Shpërblimi i Sportistëve të cilët kanë përfaqësuar Kosovën në arenën ndërkombëtare (kampionat Evropian, Ballkanik, Kupa Evropiane dhe Kupa Botërore) këta sportist mos të jenë në garë për sportist të vitit. 3. Të specifikohet: Shpërblimi për sportistin më të suksesshëm Senior, Junior dhe Kadet.

z.Lumni Amrushi; Propozoj që pikat e debatit publik të futen në rregullore. Mendoj që pesë propozimet që kanë ardhur nga debati publik të përfshihen në rregullore.

znj.Albana Fazliu, DKRS; Unë mendoj se në Rregullore duhet të futen ato tri propozime që i lexova më parë.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Konstatoi kuorumin prej 16 anëtarëve prezent në mbledhje.

*Kuvendi i Komunës së Shtimes me 8 vota “Për” me 7 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” miratoi Rregulloren Komunale për procedurat dhe kriteret për zgjedhjen e Laureatëve të vitit në sport, duke integruar në rregullore edhe 3 propozimet e dala nga diskutimi publik që i lexoi drejtoresha e DKRS znj.Albana Fazliu.

Pika 4

Draft-Strategjia e zhvillimit ekonomik të Komunës së Shtimes. (Pas diskutimit publik)

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha z.Kastriot Shabanit.

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Përshëndetje, kjo rregullore është hartuar nga ekspertët. Diskutimi publik me qytetarë është mbajtur nuk kishte propozime konkrete, ju ftojë ta votoni sikurse në KPF.

z.Muhamet Ademaj; E falenderoj drejtorin për këtë dokument të rëndësishëm, kërkojë që të zbatohet strategjia, sidomos te Zona Ekonomike në Gllavicë.

z.Hamëz Tërshani; E kam lexuar dokumentin, më ka ra në sy dukuria e korrupsionit që është përmendur në dokument si dukuri negative. A jeni ardhur ju në pushtet për me luftuar korrupsionin? E kemi përmendur 3 herë rrugën për Llanisht. Nuk pashë asgjë të re çka ka me ndryshuar në Arsim dhe Shëndetësi? Ka pasur edhe ekspertë nga Komuna unë nuk i pashë, ku jeni bazuar që i keni gjetur që ka ra interesimi për me investu. Kamë prit nga ju që keni me bërë Zonën e tretë Ekonomike . Ku është premtimi i fushatës zgjedhore?

znj.Albana Podvorica; Përshëndetje, urime viti i ri 2024 tek Kultura, Rini dhe Sport nuk përmendet fjala rini po ashtu nuk përmendet askund veprimtaria e shoqatave.

znj.Adelina Beqaj; Kur flasim për zhvillimin ekonomik më del parasysh pasqyra juaj në fushatë me premtime. Nuk e kontestoj profesionalizmin e juaj. A e din ti drejtor qe sa nuk e keni përfunduar tregin? Keni përmendur Zonën Ekonomike, e punësime, cilën zonë ekonomike e keni funksionalizuar?

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Faleminderit për pytjen, rruga për Luzhak e përmendi Hamza, në strategji është e inkuorporuar. Po ashtu edhe Zona Ekonomike është e inkuorporuar. E keni potencuar edhe korrupsionin si dukuri negative nuk ka gjë të keqe aty. Për me u funksionalizu Zona Ekonomike duhet me u miratu plani zhvillimor komunal dhe nuk është faji i DZHE-së për mos funksionalizim. Arsyeja pse nuk ka të përmendur rinin është sepse kjo është strategjia e zhvillimit ekonomik dhe aty jemi fokusuar. Me tregun e gjelbërt kemi pasë probleme me operatorin ekonomik ku e kemi shkëputur kontratën plus ju ka inkuasuar edhe mjetet e garancionit. E kemi zgjedhur operatorin për këtë punë dhe është duke u finalizuar. Është mirë mirë që po bëhet.

z.Lumni Amrushi; Deshta me repliku me drejtorin, ka thënë se janë 12 pëlqime 10 janë plotësuar e 2 jo. Tash po thonë 6 nuk janë plotësuar nuk po e kuptojë. Deri në fund të mandatit nëse mundeni me funksionalizu Zonën Ekonomik në Gllavicë do të ishte mirë. Është mirë me punu e mos me folë fjalë në hava. Është shumë keq me pjesën e rrymës, anena punojnë shumë biznese dhe e kanë problem pjesën e rrymës.

z.Rexhep Gashi; I falenderoj krejt që kanë punuar në këtë dokument. Pyetja ime është e kahershme për Stacionin e Autobusëve sepse përpara ka qenë e planifikuar në Davidovc, a keni menduar për këtë? Dhe e dyta a keni mundur me legalizuar si zonë biznesi rrugën për Davidovc e deri te Hani?

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Deri në aprovimin e planit zhvillimor të ri duhet të punojmë me planin zhvillimor të vjetër.

z.Përparim Ramusa; Faleminderit për sqarimet, këta të VV-së nuk janë duke bashkëpunuar me juve. PDK-ja e ka votuar me 37 hektar tokë e ju nuk po mundeni me i marrë pëlqimet. Leje krejt këtë punë e ne pas mandatit ja bëjmë diqysh.

znj.Adelina Beqaj; Edhe një pyetje për drejtorin te fabrikat a ke diçka me i subvencionu këto fabrika? Zonën ekonomik e ke gjetë të gatshme ne e kemi votuar e ju nuk po mundeni me funksionalizu.

z.Hamëz Tërshani; E kam lexuar Strategjinë komplet te pika 7.2 sa i përket rrjetit 110 KW të rrymës është inicuar nga ne. I kemi nja 4-5 pika të indentifikuara ku shitësit shesin mirpo nuk shkojnë te tregu. Mungesa e punonjësve në administratë që keni thënë kjo për mua është fyerje.

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Çka duhet me bërë ne? Pëlqimet që nevojiten me i dhënë, normalisht nuk duhet të zvarriten. I kemi 80 biznese që janë përfitues prej Komunës tonë deri në 25.000 mijë ero. Sa i përket rrjetit 110 KW nëse e ke bërë të ti kërkesën e nuk të

filluar nga Shtimja, Lagja e Pajtimt dhe Godanci, mirëpo dritat nuk janë ndezur ende, a ka ndonjë prishje apo pritjet që të bëhen përmirësime?

z.Gëzim Haxhiu; Kamë këto pyetje: Pyetje për DKA-në, a parashihet me u bë rregullimi i shkollës në Rashincë? Pyetje për DPUKGJ-në, te rruga “Maliq Hoxha” në Muzeqinë a parashihet me u bë ndryshim?

z.Reshat Mujota; Kamë këto pyetje: Pyetje për DZHE, me 28 qershor 2022 keni lidhur një memorandum (kontratë) me Ministrinë e Bujqësis Pylttaris dhe Zhvillimit Rural për kanalet kulluese të tokave bujqësore , sa u punu dhe deri ku ka mbërri ky projekt, dhe po ashtu një rrugë te tokat punuese në Mollopolc është premtuar që ka me u rregullu, në vitin 2024 a do të rregullohet kjo rrugë? Pyetje për DSHP-në, te salla e sportit është bërë një pastrim nga mbeturinat mirëpo atje prapë po hudhin mbeturina, kur do të bëhet një lokacion për hudhjen e mbeturinave? Pyetje për DPUKGJ-në, te pjesa e kanalizimit te lagja “Sopaj” disa pjesë të kanalizimit janë deformues të shtratit të lumit, dhe kompania nuk e ka rregullu si duhet, a e keni ndërmend me i sjellë disa gypa në vitin 2024 që me rregullu atë pjesë?

z.Asllan Beqaj; Kamë këtë pyetje: Pyetje për DPUKGJ-në, a ka me vazhdu me u rregullu trotuari dhe ndrqimi në rrugën “Nazim Bakiu” dhe në rrugën “Mehdi Korrani”?

znj.Adelina Beqaj; Janë rregullu disa vendndalje të autobusave, ka rrezikshmëri të madhe sidomos në rrugën e Petrovës ku kalimtarët rrezikohen nga kamionat e mëdhenj, fjala është te ura në Petrovë.

z.Asllan Beqaj; Tani stacioni i autobusave është zhvendos te shkolla.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Faleminderit për pyetjet.

z.Rrahman Jakupi; Gjendja në shëndetësi është katastrofale, janë dy vendime. Pyetjen e kam adresuar te Kryetari dhe te drejtori i shëndetësis për qasje në dokumente zyrtare e përgjigje nuk kamë marrë. Shqetësues është fakti se drejtori i shëndetësis ka qenë në listën e zezë si nëpunës i sigrimit të Serbisë që dyshohet. Kërkojë që kjo qeverisje ta shkarkojë atë drejtor. Në “Insajder” keni mundësi me lexu se ky drejtor është i përfshirë në një skandal që bëhet fjalë për 3 milion euro.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Përgjigjet e bëra i merrni me shkrim. Ju urojë festat e fundvitit dhe ju falenderoj për bashkpunimin gjatë vitit që po e lëmë pas. Pasi që diskutime tjera nuk kishe Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 12:41h

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi

